



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



**RREGULLORE (ARRU) NR. 06/2020 PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK**

Prishtinë, 2020

Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, në bazë të kompetencave të dhëna me nenin 4 paragrafi 3.6 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe nenit 20 paragrafi 3, të Ligjit nr. 06/L- 011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, miratoi:

Rregulloren për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Rregullorja ka për qëllim dhe përcakton termat, kushtet dhe procedurat për forcimin e integritetit dhe garantimin e kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve në Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregullore janë të detyrueshme për të gjithë zyrtarët të ARRU-së. Kjo Rregullore gjithashtu rregullon procedurat për detyrimet e raportimit, masat për parandalimin, identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik me atë privat të zyrtarit, si dhe përcakton detyrat e përgjegjësive të ARRU-së dhe Zyrtarit Përgjegjës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **ARRU** – nënkupton Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit;
 - 1.2. **AKK** - nënkupton Agjencia Kundër Korrupsionit;
 - 1.3. **Drejtori i Përgjithshëm** - nënkupton Drejtori i Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit;

- 1.4. **Interes publik** – nënkupton interesi material ose jo material i ligjshëm dhe i drejtë në dobi të qytetarëve;
 - 1.5. **Interes privat i personit zyrtar** – nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste;
 - 1.6. **LPKIUFP**- nënkupton Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit;
 - 1.7. **Person i afërm me zyrtarin** – nënkupton bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jo pasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;
 - 1.8. **Person i besuar** – nënkupton personi fizik ose juridik që ushtron në mënyrë të pavarur të drejtat e administrimit të ndërmarrjes apo të drejta të tjera të përcaktuara me marrëveshje për aksionet ose pjesët në kapital të zotëruara në mënyrë pasive nga zyrtari i lartë. Personi i besuar nuk mund të jetë bashkëshorti, fëmijët, një zyrtar apo person tjetër me lidhje varësie, qoftë edhe të tërthortë, për shkak të funksionit publik me zyrtarin në fjalë dhe një ndërmarrje ose organizatë jofitimprurëse ku zyrtari zotëron pjesë në kapital ose aksione apo ka pasur ose ka marrëdhënie interesi të çfarëdo lloji;
 - 1.9. **Zyrtar** - nënkupton çdo zyrtar të lartë dhe çdo person zyrtar sipas nën-paragrafëve 1.3. dhe 1.4 të Nenit 3 të LPKIUFP;
 - 1.10. **Zyrtar i lartë** – nënkupton zyrtarët e lartë publikë të përcaktuar sipas Ligjit përkatës për deklarin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë;
 - 1.11. **Zyrtari Përgjegjës** - nënkupton Zyrtarin Përgjegjës të emëruar për parandalimin e konfliktit të interesit brenda institucionit të ARRU.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin përkatës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Neni 4 Subjekti

Përveç kur parashihet shprehimisht ndryshe me Ligj, subjekte të kësaj Rregulle janë zyrtarët e përcaktuar sipas paragrafit 1.9. dhe 1.10. të nenit 3 të kësaj Rregullore. Personat e afërm me zyrtarët dhe personat e besuar janë subjekte të kësaj Rregullore sipas paragrafit 1.7. dhe 1.8. të nenit 3 të kësaj Rregullore.

Neni 5 Parimet për veprim dhe mosveprim të zyrtarit

Parimet për veprim dhe mosveprim të zyrtarit publik të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë zyrtarët e ARRU, janë të përcaktuara me nenin 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

KAPITULLI II

CAKTIMI DHE DETYRAT E ZYRTARIT PËRGJEGJËS

Neni 6

Caktimi i Zyrtarit Përgjegjës

1. Drejtori i Përgjithshëm me vendim cakton (emëron) njërin nga zyrtarët e ARRU si Zyrtar Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit brenda institucionit, i cili krahas detyrave të vendit të tij të punës do të ushtroj edhe detyrën e Zyrtarit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit.
2. ARRU njofton AKK-në lidhur me emërimin e Zyrtarit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit.
3. Mandati i Zyrtarit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit nuk është i kufizuar, por kur është e nevojshme të njëjtit mund t'i ndërpritet mandati apo mund të zëvendësohet me një vendim tjetër të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Përgjegjës

1. Zyrtarit Përgjegjës në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit është i autorizuar të:
 - 1.1. mbledh dhe merr informata nga burime të ligjshme në lidhje me interesat private të një zyrtari, përfshirë të dhënat publike ose private, informatat e dhënë nga mediat dhe ankesat e qytetarëve sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e informatorëve dhe sipas të gjitha dispozitave të tjera ligjore në fuqi;
 - 1.2. kërkojë nga zyrtari i përfshirë në hetimin e rastit të konfliktit të interesit të paraqesë informata shtesë ose deklaratë të interesit privat të zyrtarit;
 - 1.3. regjistrojë interesin privat të zyrtarit;
 - 1.4. verifikojë besueshmërinë e burimeve të informatës;
 - 1.5. verifikojë rastet e konfliktit të interesit dhe të vërtetoj nëse ka shkelje të dispozitave ligjore që paraqet konflikt të interesit;
 - 1.6. informoj Drejtorin e Përgjithshëm të ARRU-së lidhur me rastin e konfliktin e interesit;
 - 1.7. marrë vendime në raste të veçanta, të propozojë veprime dhe aktivitete të mëtejshme në parandalimin e konfliktit të interesit në institucion dhe të informojë Agjencinë Kundër Korrupsionit;
 - 1.8. informojë zyrtarët e rinj dhe të i këshilloj ata për parandalimin e konfliktit të interesit;
 - 1.9. kryejë aktivitete të tjera në këtë drejtim nëse është e nevojshme sipas ligjit përkatës.

- 1.10. zbaton dhe përdor formularët për deklarim dhe regjistrim të konfliktit të interesit.
2. Zyrtari Përgjegjës administron dokumentacionin lidhur me rastet e trajtuara e:
 - 2.1. plotëson regjistrin për rastet e konfliktit të interesit, i cili duhet të përmbajë të dhëna personale të zyrtarit;
 - 2.2. Regjistron interesin privat i cili ka qenë shkak për lindjen e konfliktit të interesit, burimin e të dhënave dhe mënyrën e marrjes dhe verifikimit të tyre, si dhe të dhëna tjera relevante lidhur me rastin.
3. Zyrtari Përgjegjës pas trajtimit të situatës së konfliktit të interesit, përgatit një raport lidhur me rastin sa i përket vlerësimit apo konstatimit të gjendjes.
4. Në rastet kur nevojitet përfshirja e Agjencisë Kundër Korrupsion, Zyrtari Përgjegjës obligohet të paraqes të gjitha informacionet e nevojshme të mbledhura, të cilat duhet të jenë të sakta dhe të verifikuara, e që pasqyrojnë gjendjen reale në lidhje me rastin për të cilin kërkohet asistenca profesionale.

KAPITULLI III MBLEDHJA DHE VERIFIKIMI I INFORMATËS

Neni 8

Mbledhja e informatave nga Zyrtari Përgjegjës

1. Zyrtari Përgjegjës mbledhë informatat në lidhje me konfliktin e interesit nga: burime të ndryshme. Këto burime mund të jenë nga:
 - 1.1. vetë zyrtari i përfshirë në konflikt interesi;
 - 1.2. zyrtarë të tjerë apo nëpunës të institucioneve;
 - 1.3. institucione të zbatimit të ligjit dhe institucione të tjera publike;
 - 1.4. subjekte private dhe persona të tjerë;
 - 1.5. mediat;
 - 1.6. burime të tjera të informatave (baza e të dhënave, informatat të disponueshme për publikun).
2. Informata e cila rrjedh nga burime të pa-identifikuara ose informata anonime duhet çdo herë të verifikohet.
3. Pas pranimit me shkrim të deklarimit rast pas rast, Zyrtari Përgjegjës e regjistron atë, informon Drejtorin e Përgjithshëm në lidhje me deklaratën e pranuar dhe rrethanat e përmendura në të dhe inicion procesin e verifikimit.

4. Gjatë verifikimit, Zyrtari Përgjegjës bazuar në ligjin përkatës për mbrojtjen e informatorëve dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi, mbledh dhe merr informacion nga burime të ligjshme në lidhje me interesat private të zyrtarit, përfshirë të dhënat publike ose private, informacionin e dhënë nga mediat dhe ankesat e qytetarëve.
5. Zyrtari Përgjegjës verifikon besueshmërinë e burimeve të informacionit me qëllim që të konstatoj ekzistimin e konfliktit të interesit dhe e vë në dijeni zyrtarin për atë që përbën bazën për konflikt interesi dhe i jep atij mundësinë për të provuar ndryshe nëse një gjë e tillë kërkohet nga zyrtari. Informimi i zyrtarit duhet të adresohet me shkrim, përveç në rastet kur duhet të jepet pa vonesë.
6. Kur janë mbledhur informacionet e nevojshme lidhur me rastin dhe sqarimet e zyrtarit, Zyrtari Përgjegjës përpilon raportin rreth rastit. Raporti duhet të përfshijë informacione të mbledhura nga burimet e ligjshme, gjetjet kryesore, shpjegimet e zyrtarit, rekomandimet rreth rastit dhe veprimet shtesë të përmendura më lart.
7. Zyrtari Përgjegjës pas përfundimit të procedurës së verifikimit dorëzon Raportin përfundimtar tek Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 9

Verifikimi i informatës

1. Në rast se Drejtori i Përgjithshëm zbulon se raporti nuk përmban dëshmi të mjaftueshme rreth konfliktit të interesit, rasti nuk është verifikuar si duhet ose ekzistojnë pengesa tjera që nuk lejojnë marrjen e një vendimi, raporti së bashku me udhëzimet e duhura duhet t'i kthehen Zyrtarit Përgjegjës për verifikime shtesë.
2. Pasi që Drejtori i Përgjithshëm merr vendim rreth rastit, Zyrtari Përgjegjës regjistron interesat private të zyrtarit dhe ndërmer masa adekuate për zgjidhjen e konfliktit të interesit. Rezultatet e verifikimit i komunikohen Agjencisë Kundër Korrupsion.
3. Vendimet e marra gjatë procesit të verifikimit duhet të bëhen në përputhje me procesin administrativ në institucionet publike, të justifikohen, të jenë të bazuara mirë, të arsyeshme, me të drejtën e qartë të apelimit dhe kushtet e aplikimit. Ky vendim duhet të adresohet me shkrim.
4. Nëse zyrtari nuk paraqet deklaratë rast për rast, por Zyrtari Përgjegjës merr informata për konfliktin e interesit aktual apo të mundshëm, ai i kërkon zyrtarit të dorëzojë deklaratën ose shpjegimin me shkrim. Në këtë rast, Zyrtari Përgjegjës gëzon të gjitha kompetencat e përcaktuara me ligj për verifikim. Procesi i verifikimit është i njëjti si për deklarin rast pas rasti.
5. Procesi i verifikimit duhet të regjistrohet (dokumentohet) veçanërisht - informacionet e marra nga burimet e informacionit dhe shpjegimet e zyrtarit. Të gjitha të dhënat (dokumentet) që shqyrtojnë rastin e veçantë duhet të mblihen në dosje të veçantë dhe të mbahen ndaras sipas rregullores së dokumentacionit. Qasja në këtë informacion dhe dokumentacion (dokumente) ka vetëm menaxhmenti i ARRU, Zyrtarit Përgjegjës,

Agjencisë Kundër Korrupsion dhe institucioneve të tjera shtetërore konform mandatit dhe kompetencave të tyre.

Neni 10

Veprimet e Zyrtarit Përgjegjës në rastet e konfliktit të interesit

1. Nëse gjatë verifikimit, Zyrtari Përgjegjës zbulon fakte që vërtetojnë shkelje të ligjit, ai duhet të përfshijë në vendim propozimin e veprimeve të mëtejshme duke shqyrtuar:
 - 1.1. sanksionet disiplinore;
 - 1.2. revokimin apo anulimin e një akti të ndërmarrë sipas kushteve të konfliktit të interesit;
 - 1.3. dorëzimin e materialeve tek agjencitë e zbatimit të ligjit për vendim të mëtejshëm mbi zbatimin e përgjegjësisë administrative ose penale;
 - 1.4. përgjegjësinë e zyrtarëve të cilët nuk kanë parandaluar konfliktin e interesit;
 - 1.5. analizën e shkaqeve të konfliktit të veçantë të interesit dhe propozimet për përmirësime në institucion në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit ose përmirësime të tjera të nevojshme.

KAPITULLI IV

IDENTIFIKIMI DHE MASAT PARANDALUESE TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Neni 11

Identifikimi i konfliktit të interesit dhe burimi i informatave

1. Pavarësisht çdo detyrimi tjetër ligjor, çdo zyrtar që ka njohuri ose dyshim të arsyeshëm për konflikt interesi të ndonjë zyrtari tjetër duhet ta lajmërojë udhëheqësin e drejtpërdrejtë, organin udhëheqës të ARRU ose Agjencinë Kundër Korrupsionit.
2. Palët e prekura nga veprimet e zyrtarit apo cilido person që ka njohuri dhe interesa të ligjshme duhet të ofrojnë informata të cilat i kanë në dispozicion lidhur me rastin tek Zyrtari Përgjegjës dhe Drejtori i Përgjithshëm i ARRU.
3. Personi që ofron informata të bazuara për rastet e konfliktit të interesit gëzon mbrojtje në pajtim me ligjin

Neni 12

Detyrimi për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit

1. Me marrjen e detyrës publike dhe gjatë ushtrimit të saj, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private.
2. Në rast se zyrtari publik ka dyshime apo konstaton se konflikti i interesit ka lindur ose mund të lindë, ai duhet të këshillohet dhe të informojë sa më parë udhëheqësin e

drejtpërdrejtë apo organin udhëheqës të ARRU. Gjatë kësaj kohe, zyrtari duhet të pezullojë të gjitha veprimet që ndërlidhen me këtë çështje, deri në vendimin përkatës në lidhje me rastin.

3. Çdo udhëheqës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.
4. Në rast se udhëheqësi apo organi udhëheqës i ARRU nuk është i bindur për ekzistimin e konfliktit të interesit apo ekziston dyshimi se edhe vetë ai ka ose mund të ketë konflikt të interesit, atëherë Zyrtari Përgjegjës i drejtohet AKK për marrje të vendimit për rastin.
5. Zyrtarët udhëheqës të ARRU, që nuk kanë udhëheqës të drejtpërdrejtë për situatën e përshkruar në paragrafin 3. të këtij neni i drejtohen AKK.
6. Zyrtari apo organi udhëheqës i ARRU ndërmarrin veprimet e parapara në paragrafët 1. deri në 5. të këtij neni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.

KAPITULLI V

VEPRIMET E NDALUARA DHE DEKLARIMI I INTERESAVE PRIVATE

Neni 13

Veprimet e ndaluara për zyrtarin

1. Veprimet e ndalura të zyrtarit publik gjatë ushtrimit të funksionit publik janë të përcaktuara me nenin 9 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
2. Veprimet e ndaluara të zyrtarit publik gjatë ushtrimit të funksionit publik përfshijnë, por pa u kufizuar:
 - 2.1. të kërkojë apo pranojë dhuratë apo përfitim tjetër të padrejtë për vete apo personin tjetër, ose ofertë apo premtim për dhuratë;
 - 2.2. të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit të padrejtë për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;
 - 2.3. të pretojë, ofrojë ose japë dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër të padrejtë në këmbim të ndonjë dhurate apo përfitimi të padrejtë real ose të premtuar;
 - 2.4. të ndikojë në kontraktimin, dhënien e punëve apo furnizimeve publike për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;
 - 2.5. të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër;
 - 2.6. të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik;
 - 2.7. të fitojë për vete, personat e afërm dhe të besuar çdo përfitim të padrejtë ekzistues ose të ardhshëm;

- 2.8. të ndërmarrë veprime me efekte ndëshkuese apo të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme të zyrtarëve apo subjekteve që ofrojnë informata për raste të konfliktit të interesit të zyrtarit, personave të lidhur me të ose personave të besuar për këtë shkak;
- 2.9. të përdorë ose të lejojë që të përdoren pasuritë zyrtare të ARRU, përfshirë dokumentet zyrtare, për ndonjë qëllim tjetër që nuk përputhet me ushtrimin e detyrës publike.

Neni 14

Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit

1. Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit është përcaktuar me nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit përfshijnë, por pa u kufizuar:
 - 2.1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit.
 - 2.2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht.
 - 2.3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

KAPITULLI VI

KUFIZIMET PAS USHTRIMIT TË DETYRËS PUBLIKE

Neni 15

Kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike

1. Zyrtari i lartë i punësuar në Autoritetin Rregullator për Shërbime pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike nuk ka të drejtë:
 - 1.1 të punësohet ose të emërohet, për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitat udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin të institucionit ARRU, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre;
 - 1.2 të përfshihet në marrëdhënie kontraktore, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, me institucionin e ARRU, ku ka ushtruar funksionin publik për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik;

- 1.3 të përfaqësojë, ndihmojë ose këshillojë ndonjë person fizik ose juridik, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, në një konflikt ose marrëdhënie biznesi me institucionin e ARRU, për detyrën që ai ka kryer ose që është në vazhdimësi të saj për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik; dhe
- 1.4 të përdorë informacionin e privilegjuar ose konfidencial të siguruar gjatë ushtrimit të funksionit publik për qëllime e punësime të tjera në të ardhmen për interesin privat të vet ose të një personi të afërm apo të besuar për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik.
2. Institucioni i ARRU në të cilën zyrtari i lartë ka ushtruar funksion publik nuk mund të bëjë biznes deri në një vit nga mbarimi i funksionit publik me subjektin në të cilin ish-zyrtari, personi i afërm me të apo personi i besuar kanë një pjesëmarrje prej jo më pak se pesë për qind (5%) në të drejtat e themeluesve, menaxhimin apo kapitalin, si me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet pjesëmarrjes së personave të tjerë juridikë.
3. Institucioni i ARRU në të cilin zyrtari i lartë ka ushtruar funksion publik duhet, sa më parë por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë, të informojë AKK për ndonjë nga rrethanat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni.

KAPITULLI VII

MASAT E PARANDALIMIT, MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI

Neni 16

Masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit

1. ARRU apo udhëheqësi i zyrtarit duhet të sigurohen që zyrtari në ushtrimin e funksionit publik, ka kryer këto veprime:
- 1.1. transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të ligjit (LPKIUFP);
- 1.2. merr masa për vetëpërrjashtimin ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes në konflikt me përjashtim të rasteve të përcaktuar shprehimisht me ligji (LPKIUFP);
- 1.3. jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;
- 1.4. dorëhiqet nga funksioni publik.
2. Çdo udhëheqës i zyrtarit ose institucioni i ARRU merr masat e nevojshme, të përshkallëzuara dhe proporcionale për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin real ose të mundshëm të interesave për shkak të zgjedhjes, emërimit apo

caktimit të detyrave ose përgjegjësive të caktuara të zyrtarit. Këto masa përfshijnë por nuk kufizohen:

2.1. kufizimin e informatave të caktuara për zyrtarin ose shmangien e detyrave dhe përgjegjësive që përbëjnë shkak në shfaqjen e konfliktit të interesit ose të papajtueshmërive;

2.4. përjashtimin e zyrtarit nga pjesëmarrja në vendimmarrje;

2.5. rishikimin ose ndryshimin e detyrave dhe kompetencave të zyrtarit ose transferimin në një detyrë tjetër që mënjanon konfliktin e interesit, për aq sa nuk parashihet ndryshe me ligj;

2.6. shmangien e emërimit ose të zgjedhjes së zyrtarit në funksione në të cilat ekzistojnë ose mund të lindin konflikte të interesit;

2.7. revokimin ose anulimin e një akti të marrë në kushtet e konfliktit të interesit.

3. Pavarësisht masave bazë të mësipërme dhe çdo mase tjetër të paraparë me ligjin (LPKIUFP), zyrtari ose udhëheqësi i tij sipas hierarkisë nuk përjashtohen nga përgjegjësia kur masat e marra nuk japin efekt në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit ose papajtueshmërive sipas këtij ligji.
4. ARRU ose Zyrtari Përgjegjës njoftojnë AKK për masat e marra për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit ose papajtueshmërive sipas dispozitave të parapara më këtë Rregullore dhe ligjit (LPKIUFP).

Neni 17

Autoritetet përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kësaj Rregullore janë të gjithë udhëheqësit e drejtpërdrejtë të zyrtarëve, sipas hierarkisë brenda Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit.
2. Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit është përgjegjës të:
 - 2.1. mbledh dhe pranon nga burime të ligjshme informata për interesat private të një zyrtari, përfshirë të dhënat publike ose private, informatat e ofruara nga media dhe ankesat e qytetarëve sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e informatorëve dhe çdo dispozitë tjetër ligjore në fuqi;
 - 2.2. verifikon besueshmërinë e burimeve dhe informatave për të vërtetuar konfliktin e interesit;
 - 2.3. vë në dijeni zyrtarin për informatat e siguruar për të dhe që përbëjnë shkak për konflikt të interesit dhe i jep mundësi të provojë të kundërtën nëse kjo kërkohet nga zyrtari;
 - 2.4. njofton me shkrim raportuesin e informatës brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për shqyrtimin e mëtejshëm të informatës.

3. ARRU kryen regjistrimin në formularin e interesave private të zyrtarit, ndërmerr masat e duhura për zgjidhjen e konfliktit të interesit dhe raporton tek AKK brenda afatit kohor të përcaktuar nga ajo.

Neni 18 Raportimi

1. ARRU - Zyrtari Përgjegjës obligohet t'i raportojë Agjencisë Kundër Korrupsion menjëherë pas vendimit mbi rastin por jo më vonë se 15 ditë.
2. Përveç rasteve individuale, ARRU - Zyrtari Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore i dorëzojnë raport me shkrim AKK çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar.
3. Në raportin vjetor për vitin paraprak të ARRU Zyrtarit Përgjegjës duhet t'i përfshijë raste e konfliktit të interesit, veprimet e ndërmarra, masat parandaluese ose adresimi i tyre, rezultatet e arritura dhe statusin e lëndëve.

Neni 19 Përdorimi i formularëve për deklarim dhe regjistrim të konfliktit të interesit

1. Për rastet e konfliktit të interesit nga zyrtarët e ARRU, duhet që të përdorën formularët (shtojca 1 dhe 2 e kësaj rregullore) për deklarim dhe regjistrim të konfliktit të interesit si në vijim:
 - 1.1. Formularin për Deklarimin e Konfliktit të interesit;
 - 1.2. Formularin për Regjistrimin e Konfliktit të Interesit;
2. Varësisht nga subjekti: Formulari (1) për Deklarimin e Konfliktit të interesit nënshkruhet nga zyrtari me rastin e marrjes së detyrës, punësimit, emërimit, caktimit të detyrës; dhe Formulari (2) për Regjistrimin e Konfliktit të Interesit shërben për ARRU – Zyrtarin Përgjegjës në lidhje me regjistrimin e rasteve si dhe raportimin e tyre në fund të vitit tek Agjencia Kundër Korrupsionit.

KAPITULLI VIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19 Gjuha zyrtare

Kjo Rregullore është nxjerrë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 20 Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Autoritetit.

Datë 30/10/2020





Datë ____/____/20__

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Deklarimin rast për rast i interesave private të zyrtarit, deklaroj si në vijim:

DEKLARATË E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Deklaruesi z/znj. _____

Pozita Deklaruese _____

Punëdhënësi/institucioni _____

Në cilësinë e _____, me përgjegjësi të plotë morale, penale deklaroj se nuk kam konflikt interesi sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, që do të mund të vë në dyshim kryerjen e detyrës si Anëtar/Zyrtar _____.

Gjatë gjithë ushtrimit të detyrës së këtij mandati, në rast të shfaqjes së ndonjë situatë eventuale të konfliktit të interesit, zotohem se do ta deklarojë menjëherë këtë para anëtarëve të komitetit, dhe do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të evitimit të konfliktit të mundshëm të interesit sipas legjislacionit në fuqi.

Nënshkrimi _____

Data _____



Datë ___/___/20__

FORMULAR I REGJISTRIMIT TË RASTIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Nr. rendor i rastit të pranuar dhe viti:

--	--

Institucioni:

Emri i zyrtarit:

Funksioni:

Të dhënat e zyrtarit:

(Emri dhe mbiemri)

Përshkrimi i
rastit të konfliktit
të interesit:

Arsyetimi i zyrtarit të rastit të konfliktit të interesit:

Datë:

Nënshkrimi i Zyrtarit:

Evidentoi:

Emri & Mbiemri:

Datë:

**Nënshkrimi dhe Vula e
institucioni:**

Në kuptim të Nenit 5, 6, 7, 8, 9, të Ligjit Nr. 06/L - 011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare. Për më tepër, parimet bazë, obligimet dhe të drejtat e zyrtarëve publik janë përcaktuar, por nuk kufizohen me këto si në vijim:

- Zyrtari ushtron funksionin e tij në pajtim me ligjin dhe kodin përkatës të mirësjelljes.
- Zyrtari duhet ta kryejë punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit dhe institucionit dhe me punën e tij të forcojë besimin e qytetarëve në institucione.
- Zyrtari, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet të veprojë në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vë para interesit publik.
- Zyrtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij duhet të veprojë me transparencë duke respektuar të drejtën e organeve përfaqësuese dhe të drejtën e qytetarëve që të informohen për veprimet e zyrtarit si personalitet publik.
- Zyrtari përgjigjet personalisht për veprimet e tij gjatë ushtrimit të funksionit në të cilin është emëruar apo zgjedhur nga institucioni apo qytetarët.

- Zyrtarit nuk i lejohet të kryejë një veprim të kundërligjshëm apo të mos kryejë një veprim të ligjshëm, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, me qëllim të marrjes së një përfitimi të padrejtë për vete ose një person apo subjekt tjetër.
 - Zyrtari për punën që kryen në ushtrimin e funksionit nuk ka të drejtë të pranojë apo kërkojë shpërblim tjetër si dhe ofrimin ose premtimin e shpërblimit përveç kompensimit që i lejohet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.
 - Zyrtari duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, i mundshëm apo në dukje.
 - Zyrtari nuk mund të përdorë pozitën apo funksionin e vet për t'i avancuar interesat e veta personale apo të personave të afërm.
-
- Pavarësisht çdo detyrimi tjetër ligjor, çdo person që ka njohuri ose dyshim të arsyeshëm për konflikt interesi të ndonjë zyrtari duhet ta lajmërojë institucionin punëdhënës të zyrtarit ose Agjencinë kundër Korrupsionit.
 - Palët e prekura nga veprimet e zyrtarit apo cilido person që ka njohuri dhe interesa të ligjshme duhet të ofrojnë informata të cilat i kanë në dispozicion lidhur me rastin.
 - Personi që ofron informata të bazuara për rastet e konfliktit të interesit gëzon mbrojtje në pajtim me ligjin.
 - Me marrjen e detyrës dhe gjatë ushtrimit të saj, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private.
 - Në rast se zyrtari ka dyshime apo konstaton se konflikti i interesit ka lindur ose mund të lindë, ai duhet të këshillohet dhe të informojë sa më parë udhëheqësin e drejtpërdrejtë apo organin udhëheqës. Gjatë kësaj kohe, zyrtari duhet të pezullojë të gjitha veprimet që ndërliken me këtë çështje, deri në vendimin përkatës në lidhje me rastin.
 - Çdo udhëheqës dhe institucion udhëheqës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.
 - Në rast se udhëheqësi apo institucioni udhëheqës nuk është i bindur për ekzistimin e konfliktit të interesit apo dyshon se edhe vetë ka ose mund të ketë konflikt të interesit, atëherë i drejtohet Agjencisë për marrje të vendimit për rastin.
 - Zyrtarët udhëheqës të institucioneve, që nuk kanë udhëheqës të drejtpërdrejtë për situatën e përshkruar në paragrafin 3. të këtij neni i drejtohen Agjencisë.
 - Zyrtari apo institucioni i ndërmarrin veprimet e parapara brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.
 - Agjencia ndërmerr veprimet e duhura dhe informon sa më parë subjektet jo më vonë se afati i përcaktuar në nenin 22, paragrafi 3. të Ligjit Nr. 06/L - 011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
 - Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime:
 - o të kërkojë apo pranojë dhuratë apo përfitim tjetër të padrejtë për vete apo personin tjetër, ose ofertë apo premtim për dhuratë, në mënyrë që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë në kryerjen e detyrës së tij publike;
 - o të kërkojë, përvetësojë, pranojë shpërblime, dhurata, përfitime apo shërbime të padrejta për vete ose për tjetrin si kompensim për përcaktimin e tij në vendimmarrje;

- të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit të padrejtë për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;
- të premtojë, ofrojë ose japë dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër të padrejtë në këmbim të ndonjë dhurate apo përfitimi të padrejtë real ose të premtuar;
- të ndikojë në kontraktimin, dhënien e punëve apo furnizimeve publike për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;
- të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkë aksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit;
- të ndikojë në vendimmarrje të organeve legislative, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e zyrtarit me qëllim të përfitimit të padrejtë për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkë aksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit;
- të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkë aksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit;
- të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të interesit publik;
- të fitojë për vete, personat e afërm dhe të besuar çdo përfitim të padrejtë ekzistues ose të ardhshëm, dhuratë, pjesë në kapital, aksione dhe pasuri nga ndërmarrjet publike me pjesë në kapital ose në aksione të një institucioni ku ai është përfaqësues, përfshirë përfitime të padrejta të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga furnizues apo klientë të këtyre ndërmarrjeve;
- të fitojë për vete, personat e afërm dhe të besuar çdo përfitim të padrejtë ekzistues ose të ardhshëm, dhuratë, pjesë në kapital, aksione dhe pasuri nga personat juridikë privatë që përfitojnë kontrata publike, kreditim ose fonde të tjera publike, privatizim të pronës publike, lehtësi nga detyrimet doganore ose tatimore ose që ushtrojnë veprimtari në zona të lira në rastet kur është përfshirë gjatë ushtrimit të funksionit dhe ka ndikuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në fitimin e këtyre të drejtave në dobi të tyre;
- të ndërmarrë veprime me efekte ndëshkuese apo të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme të zyrtarëve apo subjekteve që ofrojnë informata për raste të konfliktit të interesit të zyrtarit, personave të lidhur me të ose personave të besuar për këtë shkak.
- të përdorë ose të lejojë që të përdoren pasuritë zyrtare të institucionit punëdhënës, përfshirë dokumentet zyrtare, për ndonjë qëllim tjetër që nuk përputhet me ushtrimin e detyrës publike.